



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1986/3 Prot.

Vlorë më, 22.12. 2021

VENDIM

Nr. 40, datë 20.12.2020

PËR

PAGESËN E ORËVE SUPLEMENTARE PËR SEKRETARITË MËSIMORE, GJATË  
PROCESIT TË REGJISTRIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2021- 2022

Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr.568, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore", si dhe referuar propozimit të Rektorit nr.1782/5 prot, datë 13.12.2021, në mbledhjen e datës 20.12.2021 Bordi i Administrimit

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e ardhur me shkresën nr.1782/5 prot, datë 13.12.2021 për pagesën e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ (sekretaritë mësimore), për punën e kryer jashtë orarit zyrtar dhe ditëve të pushimit gjatë procesit të regjistrimit për vitin akademik 2021- 2022.
2. Efektet financiare të këtij vendimi janë 1,858,942 lekë dhe do të mbulohen nga buxheti i institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. Ervis MOCKA

